



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE
FORMULARI I NJOFTIMIT TË KONKURRIMIT PUBLIK**

1. Institucioni/Autoriteti Kontraktor - **Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Tiranë** njofton subjektet e interesuara të licencuara në zbatim, në pasuritë kulturore të marrin pjesë me ofertat e tyre publike në konkurrimin publik të shpallur nga ky institucion.
2. Emërtimin dhe vendndodhjen e objektit: **“Ndërhyrje Konservuese-Restauruese Në Burgun E Spaçit”**, Monument Kulture i kategorisë së II-te.
3. Llojin e punës: **“Ndërhyrje Konservuese-Restauruese Në Burgun E Spaçit”**.
4. Fondi limit i procedurës së konkurrimit është **10.705.261** (*dhjetë milion e shtatëqind e pesë mijë e treqind e dyqind e gjashtëdhjetë e një*) **lekë pa TVSH**, sipas preventivit të punimeve të miratuar në KKTKM.
5. Afati i realizimit të kontratës **56** (pesëdhjetë e gjashtë) ditë, nga data e lidhjes së kontratës.
6. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është **jo më pak se 8 ditë nga publikimi** i këtij njoftimi në Buletin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit Kontraktor, përkatësisht data **11.03.2025 ora 09:00**, në zyrën e protokollit të institucionit, me Adresë Rr. “Aleksandër Moisiu” Nr. 76, ish Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë, Shqipëri. **Ofertat e paraqitura pas këtij afati do të refuzohen.**
7. Afati dhe mënyra për tërheqjen e dokumenteve të konkurrimit publik: Kandidatët e interesuar mund të aksesojnë dokumentet standarde të konkurrimit publik në faqen zyrtare të Autoritetit Kontraktor: www.iktk.gov.al në Rubrikën “Rreth nesh/Njoftime”.
8. Ofertat duhet të shoqërohen nga dokumente ligjorë dhe administrative origjinale ose kopje të noterizuara si provë e plotësimit të kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentet standarde, të miratuara për këtë qëllim.
9. **Hapja e ofertave nga Njësia e vlerësimit do të jetë në datë 11.03.2025 ora 11:00** në Autoritetin Kontraktor/Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Tiranë, kati II, salla e Bibliotekës, dhe do të shqyrtohen brenda afatit prej 7-ditësh nga data e hapjes së tyre.
10. Ofertuesit apo Përfaqësues të autorizuar me shkrim të tyre mund të jenë të pranishëm në datën, orën dhe vendin e hapjes së ofertave.